



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 2143..... Prot.

Vlorë, më 18/07/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE



• Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të dy akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore (bashkëngjitur) si vijon :

- Nr.71, me Nr.1690/2 Prot., datë 130/2025, i materializuar për subjektin “Kreshnik Ramo”, me banim në Vlorë (Rajoni nr.1, Lagjja "15 Tetori").
- Nr.74, me Nr.1638/1 Prot., datë 19/06/2025, i materializuar për subjektin “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, me seli në Tiranë (Kamëz, Rruga "Rilindja", Nr. Pasurie 61/27).

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të dy akteve të lartcituara.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË**

Nr.1690/2 Prot.

Vlorë, më 16/06/2025

VENDIM Nr.71

Sot, më datë 16/06/2025, unë, Kryetari i Degës së Doganës Vlorë pasi shqyrtova procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore nr.serial 0007832, datë 10/06/2025 (Nr.1690/1 prot., D.D.Vlorë datë 10/06/2025), si dhe dokumentacionin bashkëngjitur tij, të mbajtur nga Grupi i Kontrollit pranë Degës së Doganës Vlorë,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të nenit 10 e vijues të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe të Ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit" (i ndryshuar), Zyra e Operacioneve Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit Vlorë, gjatë ushtrimit të kontrollit më datë 10.06.2025 në Pikën e Kalimit Kufitar Vlorë, konkretisht gjatë kontrollit të kryer në vijën e dytë mbi automjetin - furgon marka Mercedes Vito, AA374LC, konstatuan se nga ana e drejtuesit të mjetit shtetasit shqiptar Kreshnik Ramo me NID I20522195O, nuk ishte kryer deklarimi i të hollave në kufi. Nga ky mosveprim, rezulton se nga ana e këtij shtetasi, është konsumuar kundërvajtje administrative, e parashikuar në nenin 17/1 pika 4 (b) e Ligjit nr.33/2019. Rezulton se nga ana e organit konstatues janë mbajtur aktet shkresore si vijon : Proces Verbal i kontrollit fizik me numër serial 0001355, datë 10/06/2025, ora 11:00, administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë me nr.1690 Prot., datë 10.06.2025, në të cilin është kryer përshkrimi si vijon : *"Gjatë kontrollit në pikën e kalimit kufitar pranë Portit Vlorë, në vijën e dytë të kontrollit mes autoriteteve doganore dhe autoriteteve të Policisë Kufitare në mjetin tip Fugon – Mercedes Vito me targë AA3741LC, me drejtues mjeti shtetasin Kreshnik Ramo me nr. Pas BC7201855 dhe nr personal I20522195O. Ku u konstatuan një sasi monetare të padeklaruara sipas procedurave standarte doganore.*

Gjatë verifikimit dhe numërimit u konstatua një shifër totale prej 45.600 (dyzet e pesëmijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) euro kartmonedha të ndara si më poshtë : 2 (dy) copë – kartmonedha 100 (njëqindëshe); 666 (gjashtëqind e gjashtëdhjet e gjashtë) copë –

kartmonedha 50 (pesëdhjetëshe); 533 (pesëqind e tridhjet e tre) copë – kartmonedha 20 (njëzetshe); 10 (dhjetë) copë – kartmonedha 10 (dhjetëshe). Gjithashtu, nga ana e organit konstatues në këtë akt shkresor është pasqyruar në kollonën “Shënime” si vijon : “Autoriteti doganor do të vijojë me procedurat duke mbajtur proces verbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative i cili do ti bashkëlidhet këtij konstatimi. Sasia fizike e mjeteve monetare do të mbikqyret nga Policia Kufitare për shkak të pamundësisë së kushteve për ruajtjen nga Autoriteti Doganor”.

Më tej, është vijuar me mbajtjen e aktit me lëndë “Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore” me nr.serial 0007882, datë 10/06/2025 (Nr.1690/1 prot., D.D.Vlorë datë 10/06/2025), në të cilin është kryer përshkrimi i shkeljes doganore si vijon : *“Sot më datë 10.06.2025 gjatë kontrollit fizik të shtetasit Kreshnik Ramo me nr.personal II205221950 në mjetin me targa AA374LC iu konstatuan shuma monetare prej 45.600 (dyzet e pesëmijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) euro të padeklaruara. Shtetasi Kreshnik Ramo do të penalizohet në masën 40.000 lekë, sipas nivelit për shumat nga 20.000 – 49.999 euro për herën e parë, sipas neneve 17/1, 259 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”.* Rezulton se të dy aktet shkresore të lartcituara, janë nënshkruar pa rezerva nga subjekti shkelës, i cili nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës kundërshtim/ankim të mundshëm.

Në përfundim, u arrit në konkluzion se nga ana e shtetasit të sipërcituar është kryer kundërvajtje administrative lidhur me mosdeklarimin e të hollave nga ana e subjektit në hyrje të territorit doganor të R.SH. Në lidhje me masën e penaltetit, në nenin 17/1, pika 4 (b) e Ligjit nr.33/2019, është parashikuar si vijon : *b) për shumat nga 20.000 – 49.999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë për herën e parë, 20 % të vlerës së padekluar për herën e dytë, si dhe 40 % të vlerës së padekluar për rastet e tjera;*

Për sa më sipër, në bazë të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i R.SH” (i ndryshuar), V.K.M-së nr.651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014”, (i ndryshuar), si dhe nenit 17/1 pika 4 (b) e Ligjit nr.33/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, akteve ligjore dhe nënligjore në mbështetje dhe zbatim të tyre, Vendimin Nr. 480, datë 1.8.2023 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për procedurën e deklarimit në kufi dhe vendosjes së sanksioneve administrative nga autoritetet doganore”,

VENDOSA:

1. Të dënoj me gjobë shtetasin “**Kreshnik Ramo**” (i identifikuar me NID me numër I205221950), në shumën **40.000** (Dyzetëmijë) lekë.
2. Për të proceduar më tej ngarkohen Zyra e Operacioneve Doganore, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit Doganor në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi.
3. Kundër këtij vendimi mund t’i paraqisni Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Për të paraqitur ankesën, duhet të garantoni për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen. Gjithashtu, duhet të bashkëshoqëroni ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij, sipas përcaktimeve të nenit 282 të Kodit Doganor.

KRYETARI

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1638/1 Prot.

Vlorë, më 19/06/2025

VENDIM Nr.74

Sot, më datë 19/06/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, me seli në Tiranë (Kamez Rruga "Rilindja", Nr. Pasurie 61/27; Nr.Telefoni 0686063988), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032705, nr.1638 Prot., datë 05/06/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjisilacionin në fuqi”, për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë “Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë”, protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E është mbajtur konstatimi si vijon : “*Autorizimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nr. **P20221004/14600/1**, i operatorit ekonomik “Albanian Shoes Corporation 2 ” sh.p.k, Vlorë, me Nipt L31311002E, rezulton i pa mbyllur, brenda afatit të autorizuar 12 mujor :*

Txi Rsv_ P20221004/14600/1						Tar Pro Est						
						5300						
Date	DAV-i	Tip	No	NK8	Pershkrimi	P. Neto	Vi. Euro	Vi. Statis	Tax Dog	TAM	TVSH	Detyri m
04/10/2022	13594	IM	5	39269097	FORMA PLASTIKE	358.4	564	71,955	0.0	8,400	16,071	24,471
Grand Total						358.4	564	71,955	0.0	8,400	16,071	24,471

Nga auditimi i dosjes së dokumentacionit fizik të subjektit përfitues të këtij autorizimi dhe në Sistemin Asycuda (Processing Program and CUO) u konstatua se afati i autorizimit ka përfunduar, ndërkohë që subjekti nuk i ka dhënë destinacion doganor mallrave të importuara në RLP, si dhe nuk ka depozituar në D.D.Vlorë kërkesë për shtyrjen e afatit të rieksporit. Për kundravajtjen administrative doganore të konsumuar nga operatori ekonomik nga Zyra e Mbikëqyrjes, nuk është mbajtur procesverbal konstatimi në zbatim të kërkesave të nenit 273, të Kodit Doganor. Për këtë arsye, vlerësojmë se dega e doganës të bëjë verifikim në ambientet e operatorit:

- Në rast se **malli gjendet në këto ambiente**, të njoftohet operatori për dhënien destinacion mallit nëpërmjet rieksporimit ose hedhjes në qarkullim të lirë. Në këtë rast, nga operatori ekonomik është konsumuar kundërvajtja doganore e parashikuar nga nenet 250/1/"a" dhe 252/"c" e Kodit Doganor dhe të sanksionohen sipas nenit 257/1/"b", të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në shumën 50 000 lekë.
- Në rast se **mallrat nuk gjenden në ambientet** e operatorit, pra nëse rezulton që ato janë hedhur në qarkullim të lirë pa kryer procedurën doganore import 4/hedhje në qarkullim pas RLP-së me përjashtim të plotë, nga ana e operatorit ekonomik është konsumuar kundërvajtja doganore e parashikuar nga nenet 250/1/a dhe 253/b të Kodit Doganor dhe të sanksionohet sipas përcaktimeve të nenit 258/1/"a", të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, përkatësisht 24,471 lekë detyrime doganore + 73,413 lekë penalitet (3 fish i detyrimit doganor të shmangur).

Më tej, nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë". Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua "Plani i Punës" me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtrim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032705, nr.1638 Prot., datë 05/06/2025, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : "Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23/01/2025, subjekti "Albanian Shoes Corporation 2", nuk ka mbyllur autorizimin e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë Nr.14600/1, dt. 04.10.2022, brenda afatit ligjor të përcaktuar në autorizim".

Subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur, pasi është njoftuar me anë të shkresës nr.1709 Prot., datë 11/06/2025, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Ndërsa në nenin 257, 1/b kemi : *1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm : b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.*

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Albanian Shoes Corporation 2” sh.p.k me NUIS L31311002E, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i R. së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj